

# SPECIFIKIME TEKNIKE

## RESTAURIMI I URES NE PERROIN E BENJES



## **Seksioni 1. SPECIFIKIME TE PERGJITHSHME**

Personi Fizik apo juridik(kontraktuesi) I cili do të zbatojë projekt restaurimin duhet të jetë I licëncuar në bazë të Nenit nr.17Nr 9048, datë 07.04.2003 ,”Për Trashëgiminë Kulturorë”, I ndryshuar.

### **Specifikime të përgjithshme**

#### **1.1.1 Njësitë matëse:**

Në përgjithësi njësitë matëse kur lidhen me kontratat janë njësi metrike në mm,cm,m,m2,m3,Km,N(Njuton) ,Ton(1000kg) dhe gradë celcius.Pikata dhjetore janë të shkruara si “.”.

#### **1.1.2 Qëllimi i punës**

Kontraktori duhet të bëjë kujdes në zbatimin e punimeve sipas projektit të miratuar nga KKR në përputhje dhe me kushtet e kontratës si dhe të plotësojë cdo difekt gjatë punimeve .Kontraktuesi do të sigurojë qe drejtuesi Teknik I punimeve restauruese të jetë present gjatë gjithë procesit të zbatimit të punimeve,gjithashtu personelili I kualifikuar për këto tipologji punimesh.Materialet ,paisjet dhe të gjitha sendet e tjera ,qoftë të një natyre të përkohëshme ose të përherëshme ,të nevojshme për zbatim dhe përfundimin e punëve dhe për korigjimin e ndnjë defekti ,për aq sa është e specifikuar në këtë document ,ose mundt të nxirret në mënyrë të arsyeshme gjatë zbatimit të kontratës nga Drejtuesi I Projektit më tej I quajtur Mbykqyrës Punimesh.

#### **1.1.3 Grafiku i punimeve**

Kontraktuesi duhet ti jap mbykqyrësit të punimeve një program të plotë duke I treguar rendin ,procedurën dhe metodën sipas të cilave ,ai propozon të punohet në restaurimin deri në mbarim të punës.

#### **1.1.4 Informacioni që duhet ti sigurohet mbykqyrësit të punimeve duhet të përfshijë:**

- Vizatime grafike që tregojnë rregullimin general të ambienteve të ansamblit dhe të ndnj ndërtimi apo structure tjetër të përkohëshme ,të cilat ai I propozon për përdorim.
- Detaje të vendosjes konstruksionale dhe punëve të përkohëshme.
- Plane të tjera që ai propozon ti adaptojë për ndërtim e restaurim dhe përfundim e të gjitha punëve ,si dhe në vijim.
- Detaje të fuqisë puntore të kualifikuar.

Mënyra dhe rregulli që janë propozuar për të ekzekutuar këto punime permanente është temë për tu rregulluar dhe aprovuar nga mbykqyrësi I punimeve të restaurimit ,dhe cmimi I kontratës duhet të jetë I tillë që të përfshijë cdo rregullim të nevojshëm,të kërkuar nga mbykqyrësi I punimeve gjatë zbatimit të punimeve.

### **1.1.5 Punime të gabuara :**

Cso punë që nuk është në përputhje me projektin e miratuar nga KKR,dhe këto specifikime duhen refuzuar dhe kontraktuesi duhet të riparojë cdo defect me shpenzimet e veta ,sipas projektit.Në rastin kur kontraktori I punimeve restauruese gjykon të adaptojë punime gjatë procesit të restaurimit ne funksion të këtij procesi ,cdo ndryshim bëhet me aprovim te Mbykqyësit të Punimeve dhe këto adoptime nuk duhet të prekin thelbin e projektit.

### **1.1.6 Punime të rrezikshme :**

Magazinimi I bomblave të gazit me presion në bodrume ,kafaz shkallësh ,korridoret dhe daljet e emergjencës është e ndaluar.Gjatë punimeve të rrezikshme me gazrat e ndezshme duhet mbajtur fikësee zjarrit sipas DIN EN3 duhet të jetë në dispozicion pranë vendit ku punohet.

### **1.1.7 Tabela njoftuese,etj:**

Asnjë tabelë njoftuese nuk duhet vendosur përvec :Kontraktori do të ndërtoj dy tabela që përmbajnë informacion të dhëna nga Mbykqyrësi I Punimeve dhe vendosen në vendet e caktuara nga ai.Fjalët duhen shkruar në mënyrë të tillë që të jenë të lexueshme nga një distancë prej 100m.Gjuha e shkruar duhet të jetë në shqip.Kosto e këtyre tabelave duhet të përfshihet ne preventivin e punimeve.

### **1.1.8 Sigurimi Teknik:**

Kontraktori do të zbatojë të gjitha punimet sipas standarteve Europiane dhe Shqiptare të sigurimit Teknik në punë.Ai duhet të sigurojë një plan pune për sigurimin Teknik dhe staf të kualifikuar për inspektimin e sigurimit Teknik,kryerjen e instruktimit Teknik për cdo punonjës dhe për cdo zë pune specific.Gjatë punimeve të prishjes ,puntorët duhet të veshin rroba të duhura të sigurisë duke përfshirë syze në mbrojtje të syrit,maska pluhuri,këpucë të sigurisë,doreza të punës dhe kasketa të forta.Mbajtjen e procesverbaleve për cdo lloj aksidenti në punë dhe mbarëvajtjen e sigurimit Teknik të cilin duhet tja prezantoj Mbykqyrëst cdo muaj.

## **1.2 Dorëzimet te Mbykqyrësi i Punimeve:**

### **1.2.1 Autorizimet me shkrim:**

“Rregullat me shkrim” di ti referohen cdo dokumenti dhe letre të nënshkruar nga Mbykqyrësi I Punimeve të dërguara kontraktuesit që përmbajnë instruksione ,udhëzime ose orientime për kontraktorin në mënyrë që ai të realizojë zbatimin e kësaj kontrate .Fjalët e aprovuara ,të drejtuara ,të autorizuara ,të kërkuara ,të lejuara të urdhëruara ,të instruktuar ,të emëruara ,të konsideruara

të nevojshme ,urdhëresa ose jo ( duke përfshirë emra ,folje,mbiemra dhe ndajfolje) të një rëndësie ,do të kuptohet që aprovimet e shkruara,drejtimet,autorizimet ,kërkesat lejet,rregullat instruksionet ,emërimet ,urdhëresat e Mbykqyrësit të punimeve do të përdoren deri në daljen e një plani tjetër pune.

### **1.2.2 Dorëzimet tek Mbykqyrësi I punimeve:**

Kontraktori duhet ti dorëzojë Mbykqyrësit për cdo punim shtesë ,një vizatim të detajuar dhe puna duhet të fillojë vetëm pas aprovimit nga Mbikqyrësi .Kontraktori duhet të nënshkruaj propozime ,detaje ,skica llogaritje,informacione,materiale,certifikata,testi kurdo që të kërkohet nga Mbykqyrësi I Punimeve I cili do të pranojë cdo dorëzim dhe nëse janë të kontratës.Cdo pranim duhet bërë me data në marveshjen me Mbykqyrësit e Punimeve dhe duke iu referuar programit të aprovuar dhe kohës së nevojshme që I duhet Mbykqyrësit për të bërë këto pranime.

### **1.3.2 Kopjimi I vizatimeve .(vizatimet sic është zbatuar)**

Kontraktori duhet të përgatisë vizatimet për të gjitha punimet “ sic janë zbatuar faktikisht” në terren.Gjatë zbatimit të punimeve në kantier ,Kontraktori do të rruajë të gjitha informacionet e nevojshme për përgatitjen e “Vizatimeve sic është zbatua “ .Do të shënojë në mënyrë të qartë vizatimet dhe të gjitha dokumentat e tjera të cilat mbulojnë punën e vazhdueshme të përfunduar .Këto vizatime do të azhurnohen në mënyrë të vazhdueshme dhe do ti dorëzohen Mbykqyrësit të punimeve cdo muaj për aprovim ,pasi punimet të kenë përfunduar ,së bashku me kopjen përfundimtare.Materjali mujor do të dorëzohet në kopje letër.

Vizatimet e riprodhuara do të përfshijnë pozicionet dhe shtrirjen e të gjithë konstruksioneve mbajtëse të lëna gjatë gjurmimeve dhe vendosjen ekuivalente të të gjitha shërbimeve që janë ndeshur gjatë ndërtimit.Kontraktori gjithashtu duhet të përgatisë seksionet e profilit gjatësor të rishikuar ,pajisur me shënimeet që tregojnë shtresat e tokës që hasen gjatë të gjitha punimeve të gjurmimit .

Si përfundim ,kopje e riprodhuar të vizatimeve ,(sic është zbatuar) do ti dorëzohen Mbykqyrësit të Punimeve.

### **1.2.3 Mostrat:**

Kontraktori duhet të sigurojë monstat,të etiketuara sipas të gjitha përshtatjeve ,aksesorëve dhe tema të tjera që mund të kërkohen me të drejtë nga Mbykqyrësi për inspektim .monstra duhet dorëzuar në zyrën e Mbykqyrësit.

### **1.2.4 Zëvendësimet:**

Zëvendësimi I materialeve të specifikuara do të bëhen vetëm me aprovimin e Mbykqyrësit të Punimeve I cili duhet të jetë I argumentuar dhe në funksion të përmirësimit të cilësisë apo origjinalitetit të veprës. Nëse materiali I propozuar për tu zëvendësuar është I njëjtë ose më I mirë se materiet e specifikuar ose nëse materialet e specifikuara nuk mund të sillen në sheshin e ndërtimit në kohë për të përfunduar punimet e kontratës për shkak të kushteve jashtë kontrollit të Kontraktorit ,që kjo të merret në konsideratë ,kërkesa për zëvendësim do të shoqërohet me njedokument dëshmi të cilësisë.

#### **1.2.5 Vizatimet e punimeve të zbatuara dhe librezat e masave:**

Kontraktori do të përgatisë dhe dorëzojë Mbykqyrësit tre grupe të dokumentacioneve të punimeve sipas projektit. Ky material duhet të përmbajë një komplet të vizatimeve të projektit të zbatuar, vizatime shtesë të bëra gjatë zbatimit të punimeve të aprovuara nga Mbykqyrësi ,si dhe librezat e masave për cdo volum pune.

#### **1.2.6 Dokumentat dhe Vizatimet:**

Kontraktori do të verifikojë të gjitha dimensionet ,sasi dhe disjet të treguara në vizatimet ,grafikët ose dhe të dhëna të tjera dhe punëdhënësi nuk do të mbajë përgjegjësi për ndonjë mangësi ose mospërputhje të gjetur në to. Mos zbulimi ose korrigjimi I gabimeve ose mospërputhjeve nuk do ta lehtësojë Kontraktorin nga përgjegjësia për punë të pa kënaqshme. Kontraktori do të marrë përsipër të gjitha përgjegjësit në bërjen e llogarive të mahësive ,llojeve dhe sasive të materialeve dhe paisjeve të përfshira në punën që duhet bërë sipas kontratës .Ai nuk do të lejohet të ketë avazntazhe nga ndj gabim ose mospërputhje ,ndërsa një udëzim I plotë do të jepet nga punëdhënësi nëse bën gabime të tilla do të zbulohen .

#### **1.2.7 Fotografitë e sheshit të ndërtimit:**

Kontraktori duhet të bëjë fotografi me ngjyra sipas udhëzimit të Mbykqyrësit të Punimeve në vendin e punës për të demonstruar kushtet e sheshit përpara fillimit ,progresin gjatë punës së ndërtimit dhe mbas përfundimit të punimeve.

### **1.3 Objektet Ekzistuese**

#### **1.3.1 Shërbimet e brendshme :**

Prioritet është që para fillimit të punimeve të prishjes shërbimet komunale në zonën e prishjeve do të nxiren jashtë funksioni dhe të sigurohen që rifutja në punë e paqëllimshme të ndaloher.

**1.3.2** Gjatë prishjes së elementeve te suvatuar të tillë si murre ,xokol,suvaja duhet prerë pastër në kufijtë e seksionit të prishur.

**1.3.3** Betonet dhe pllakat:

Prrerja me sharë e betonit duke hapur dhe pllakat në një theklësi prej 5 centimetra nën gjëndjen ekzistuese pranë.Prerjet të jenë të drejta dh në kufijtëm e shtresës që do hiqet.Matrapikët do të përdoren vetëm në pjesën e prerë dhe nuk do të përdoren në vend të sharrës.

### **Punimet gjate restaurimit.**

**Skelerite:** Objekti Ura e perroit te Benjes para fillimit te punimeve duhet te pajantohet. Per pajantimin e saj do te vendosen skeleri celiku qe perdoren per soleta KTZ dhe STASH A. Kjo behet per te siguruar objektin gjate zhvillimit te punimeve per te shmangur cdo rrezik te mundshem. Qe te mos pengoje zhvillimin e punimeve te germimit dhe betonimit ne anen e majte te ures. Skeleria do te perdoret me pas per riparimin e mureve, pastrimin nga vegetacioni, shkarkimet e ndryshme.

### **Punimet e germimit per betonimin e kembes.**

Para se te filloje betonimi i kembes do te pastrohen me kujdes si perfaqja e betonimit ashtu edhe pjesa ballore per ankorimin e hekurave. Hapja e vrimave do te behet me trapano dore duke eliminuar tronditjet e medha. Pasi te happen vrimat, do te mbushen me cemento 1:1 dhe do te futen pjeset metalike me goditje te lehta.

Pasi te futen hekurat do te filloje vendosja e armimit dhe hedhja do te behet sa me mire duke respektuar pozicionet e hekurave. Armatura duhet te jete betoforme qe siperfaqja te dali sa me e paster. Betonimi te behet mundesisht me betonjere me beton te moshes se larte M.300. Duhet te behet kujdes qe siperfaqja dhe bazamenti te jene te pasterta gjate betonimit dhe te mos behet pis siperfaqja e gureve. Kur kryhet betonimi duhet te vendosen disa tubo plastike qe te kryejne rolin e drenazhimit.

### **Pastrimi nga bimesia ne trup dhe bimesia e ulet anesore.**

Pasi te kryhet betonimi i kembes hapi tjetër vazhdon me pastrimin e objektit nga bimesia qe ndodhet ne trup dhe ne te dy krahet e ures duke sheshuar bazamentin ne menyre qe kalimtarete te kene mundesi ta dallojne lehte gjate kalimit dhe aktiviteteteve te ndryshme.

### **Punime per restaurimin e muratures dhe shtokime ne trupin e ures.**

Pasi behet betonimi i kembes se demtuar, pas 3 – 4 ditesh fillon procedura e restaurimit te pjeses mbeshtetese te kembes ne krahun e djathte. Me pas behet plotesimi i gureve te rene dhe shtokime ne pjese te ndryshme te ures.

### **Vendosja e kapredhesis.**

Ne drejtim te rrjedhes rreth 15 m. nga aksi i ures do te behet ndertimi i nje kapredhesis ku kuota e siperme te jete 10 cm mbi nivelin e ujit, te komba e ures. Kjo mase hidroteknike meret per te kthyer kete pjese te perroit nga gerryes ne mbushes. Kjo do te beje te mundur parandalimin e gerryerjes se bazamentit te ures dhe detyrimisht te kembeve me kalimin e kohes.

### **Vendosja e pllakave te gurit mbi bazamentin e kapredhesis.**

Per efekt vizual, ne pjesen e siperme te kapredhesis do te shtohet nje rresht me pllaka guri. Ato do te fiksohen me llac /cemento mbi bazamentin e betonit. Ato do te kene trashesi mbi 6 cm. Kjo behet per te qene te qendrueshme gjate vershimit te perroit.

**Konceptoi:**

**DRTK GJIROKASTER:**

Ing. Vasil Polo

Ark. Rodhalia Dhima

**IKTK:**

Ing. Zaim Lila

Ark.Joli Mitrojorgji